



Përfundojnë ndërtimet në gjimnazin "Loyola" të Prizrenit

## Ruecker: Kosova është në rrugë të mirë në këtë kohë vendimtare

"Ne do t'i ndihmojmë të gjitha shkollat në Kosovë, në mënyrë që të ecet përpara, llogaris në ju dhe jam i bindur se së bashku do t'ia dalim", është shprehur komandanti i KFOR-it, Roland Kather

**KOHA** **BASHKIM SUSURI**

PRIZREN, 16 PRILL - Me një ceremoni rasti, të hënën, është shënuar përfundimi i punimeve të kompleksit shkollor "Loyola Gymnasium" dhe 2-vjetori i vënies së gur themelit të ndërtimit të kësaj shkolle. Në ceremoni, përveç nxënësve të kësaj shkolle dhe prindërve të tyre, kanë marrë pjesë shumë mysafirë në mesin e të cilëve edhe kryeadministratori i Kosovës, Joachim Ruecker, komandanti i KFOR-it gjenerali Roland Kather, pastaj kryeshefja e ekzekutivit dr. Mybera Mustafa, nënkryetari i KK-së Ercan Shpat, nunci i Vatikanit ipeshkvi Sbarbaro, ipeshkvi i Ipeshkvisë së Kosovës imzot Dodë Gjergji, përfaqësuesit e ipeshkive të Shqipërisë, Maqedonisë e të Malit të Zi, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame Ali Efendi Veçaj e të tjerë. "Sot gjysma e Kosovës është në Amerikë, ndërsa gjysma tjetër është në këtë ceremoni në Prizren", ka thënë kryeadministratori i Kosovës, Joachim Ruecker, dhe ka shtuar se Kosova nuk është vetëm demokratike dhe multietnike. Ai është shprehur të jetë shumë i kënaqur që në mesin e të pranishmëve është edhe kryetari i KBI-së Ali Efendi Veçaj.

"Të gjitha këto tregojnë se Kosova është në rrugë të mirë në këtë kohë vendimtare për të", ka thënë Ruecker. Duke konstatuar se më shumë se gjysma e popullatës së Kosovës janë të rinj nën moshën 25 vjeç komandanti i KFOR-it gjenerali Roland Kather ka thënë se "rinia është ardhmëria e Kosovës, andaj ajo duhet ta kultivojë respektin e ndërsjellë, dialogun, mirëkuptimin dhe tolerancën". Duke i uruar suksese nxënësve të kësaj shkolle, gjenerali Kather ka thënë se nga ky institucion më standarde evropiane duhet të dalë një sinjal që tregon se kultura dhe arsimit janë shtylla kryesore të një shoqërie të mirëfilltë, ndërsa ky sinjal duhet

të dalë nga secili i ri pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare etj. Ai edhe me këtë rast ka përsëritur se KFOR-i do ta përkrahë Kosovën jo vetëm në aspektin e sigurisë. "Ne do t'i ndihmojmë të gjitha shkollat në Kosovë, në mënyrë që të ecet përpara, llogaris në ju dhe jam i bindur se së bashku do t'ia dalim", është shprehur Kather. "Gjimnazi Loyola është një dhuratë për familjet e Prizrenit e të Kosovës për shkollimin e fëmijëve të tyre me standarde evropiane", ka thënë ipeshkvi i Ipeshkvisë së Kosovës, imzot Dodë Gjergji. Ai pastaj ka shtuar se shumë familje kosovare kanë ëndërruar që t'i dërgojnë në shkollim fëmijët e tyre në ndonjë vend evropian, ndërsa sot kjo ëndërr e tyre është bërë realitet, ngase në Prizren po funksionon një shkollë me standarde evropiane. "Kjo shkollë është një pjesë Evrope në Kosovë, mirëpo përmes kësaj shkolle edhe një pjesë e Kosovës do të jetë Evropë", është shprehur ipeshkëv Gjergji. Ndërsa, duke i përshëndetur të pranishmit në emër të Papa Benediktit XVI, nunci i Vatikanit - ipeshkvi Sbarbaro, përveç tjerash, ka thënë se hapja e këtij gjimnazi ka rëndësi të madhe, ngase është i hapur për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike e fetare. "Uroj që kjo shkollë të kontribuojë për paqe e mirëqenie të popullit të Kosovës", është shprehur ipeshkvi Sbarbaro. Në emër të Kuvendit të Komunës, të pranishmit i ka përshëndetur nënkryetari Ercan Shpat. "Sot Prizreni po e përjeton edhe një ditë gëzimi, ngase prizrenasit janë mësuar që të jenë të parët në çdo lëmë", është shprehur Shpat dhe ka shtuar se brezat e ardhshëm që do të dalin nga kjo shkollë do të jenë elita dhe ardhmëria e Kosovës. Ndërsa drejtori i gjimnazit "Loyola", Walter Happel, ka falënderuar të gjithë donatorët që kanë investuar për ndërtimin e kësaj shkolle.

Aktualisht në këtë shkollë mësimet i ndjekin 318 nxënës nga pothuajse të gjitha viset e Kosovës, ndërsa mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, anglishte, gjermanishte dhe latinishte, kurse kapaciteti i plotë i shkollës është për 750-800 nxënës.